

Përmbajtja e letrës së Akademisë “Rrënjët Tona” dhe “Aleancës për Mbrojtjen e Butrintit”


LIGJI I BUTRINTIT – LIGJ PA FRYMË KOMBËTARE DHE KUNDRA UNESKO-S

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Butrintit që kaloi në Parlamentin¹ shqiptar duhet ndalur në Presidencë

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Butrintit, parashikon krijimin e një “Fondacioni” të ri, që do të menaxhojë vetëm qytetin antik të Butrintit, duke e ndarë atë nga sipërfaqja e përgjithshme aktuale e Parkut Kombëtar prej 9424 hektarësh. Qyteti antik ka një sipërfaqe prej 614 hektarësh dhe njihet si zona A-3 që është një pjesë e sipërfaqes prej 2500ha që mbrohet nga UNESCO². Aktualisht, i gjithë Parku Kombëtar menaxhohet nga agjensitë shtetërore dhe përfshin, si qytetin antik, ashtu edhe pjesën natyrore përreth qytetit. Autoritetet shqiptare thonë se do të dëshironin ta shtrinin menaxhimin në gjithë sipërfaqen prej 9424 ha, por sipas ligjeve në fuqi, kjo nuk është e mundur. Në dokumentin e miratuar thuhet se - sipas rregullimeve aktuale nuk mund të krijohet një Fondacion i pasaçëm për mbarë Parkun Kombëtar, edhe nëse kjo do të ishte e dëshirueshme.

Si menaxhohej Butrinti më parë?!

Ministria e Kulturës ngriti atëherë një grup ndër-institucional për hartimin e planit nën drejtimin e Parkut të Butrintit ku pjesë e parkut ishte kryesisht instituti i Monumenteve të Kulturës – IMK. Ky proces u mbështet financiarisht po nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Studimi përfundoi në vitin 2013 dhe nuk parashikonte menaxhimin e Butrintit përmes një pale të tretë, por përmes forcimit të kapaciteteve dhe bashkërendimit



¹ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/Pr>
² <https://whc.unesco.org/en/list/570/>

nga institucionet shqiptare. Studimi, gjithsesi mbeti në formë projekti dhe nuk u miratua ndonjëherë nga pala socialiste që erdhi në pushtet dhe vazhdon edhe sot.

As bordi dhe as menaxhmenti i AADF nuk kishin njohuri apo përvojë të gjerë në fushën e ruajtjes ose menaxhimit të zonave arkeologjike dhe të trashëgimisë kulturore. Prandaj Bordi miratoi vetëm konceptin dhe buxhetin për bashkëdrejtuesit për të një studim dhe kërkim të thelluar, si dhe punësoi konsulentët e nevojshëm për të ndihmuar në përgatitjen e draftit të Planit të Menaxhimit të Integruar. Bordi autorizoi gjithashtu bashkëdrejtuesit të vizitojnë disa vende të njohura të trashëgimisë në Evropë për të mësuar se si vendet e tjera i menaxhojnë ato. Ishte përgjegjësi e bashkëdrejtuesve që të ndërmerrnin hapat e nevojshëm në bashkëpunim me aktorët e kaluar dhe të tanishëm dhe të dilte me draftin më të mirë të Planit të Menaxhimit të Integruar.

Për ta përmbledhur, po sjellim vetëm fjalët e Gjora Solar, ish sekretari i ICOMOS (dega e UNESCO për sheshet arkeologjike): „*Kam qenë drejtuesi i një ekipi që përbëhej nga shqiptarë. Vetëm sa kam rishikuar raportet e përgatitura nga ekspertët vendas, të cilët ishin dhe janë shumë mbreslënëse*“.

Nëse bëjmë një përmbledhje të të gjitha kërkimeve arkeologjike dhe studimeve të mëparshme mbi dhe për Butrintin sot mund të themi me plot gojë se:

Butrinti – Troja në miniatyrë

Mos harroni se Butrinti quhej nga Virgjili, Troja në miniatyrë - Kështjella - Sipas shkrimtarit të lashtë, Stefan Bizantinit, ishte themeluar nga Heleni, vëllai i heroit të famshëm trojan, Hektorit: “...tregojnë legjendën se emrin ia vuri Heleni, kur duke lundruar nga Troja për në Perëndim, bëri fli gjatë zbritjes së tij në Epir. Ardhjen e trojanëve në Buthrot e tregon edhe një kodër e quajtur Troja, të cilën ata e përdorën për të ngritur lëmin. Në këtë poemë, ai tregon rrugën e gjatë që bën Eneu që nga Troja, të cilën e braktis mes flakëve, duke mbajtur mbi supet babain e tij plak, Ankizin, dhe duke tërhequr prej dore të birin, Julin. Pra, Kaoni djali i Priamit, kishte ardhur para Eneas në Butrint, të cilën e quajti atë Troja e vogël. Veprimtaria në Butrint ra dukshëm me vërshimin e fiseve Gote, aty nga shekulli i VIII pas krishtit. Një heshtje thuajse e plotë bie mbi të gjatë 10 shekujve. Në shekullin 16-17 ishte për pak kohë nën zotërimin e Venedikut dhe me ardhjen e turqve, Butrinti, jo pa qëllim, thuajse braktiset. Sepse mbajtja gjallë e tij mund të bënte që shqiptarët t’ë kujtoheshin se kush ishin dhe nga vinin. Gjithsesi, ai ngelet qytet trojan, qytet që priti e përcolli me mijëra trojanë, duke i gatitur ata për civilizime dhe mbretëri të reja. Ju kujtojmë themeluesit e Romës, Jul Cesarin, Aleksandrin e Madh, Pirron e Epirit, që të gjithë mbaheshin si stërnipër të Akilit apo pellazgëve hyjnorë. Në librin III të Eneidës, në vargjet 502 etj., Enea, në çastin kur nisët nga brigjet e Epirit, për të dalë në Otranto, bën këtë lutje: “Dua që këto qytete aleate e këta popuj kushërinj, të Epirit dhe Hesperia-s, që kanë të njëjtin themelues, Dardanin, të kenë në zemër vetëm një Trojë”.



Histori të treguara nga Virgilili

Butrinti është një nga perlat e së kaluarës, me histori të treguara nga Virgilili - Hymë në Qytetin fisnik Buthrot, ku sundonte i biri mbretit Trojan Priam. Na njohu dhe plot gëzim na shpuri në pallat dhe pashë një Trojë ndërtuar sipas të madhes. Mbreti na priti në portikët e gjerë të pallatit, ku pimë me kupat e arta..... Po këto përshkrime përmenden edhe nga Straboni, Plutarku, etj. Kujdes! Trojan, sinonimi i armikut të Grekëve. Për Butrintin tregohen mitologji, ku flitet për Panin ilir, sesi në ishullin Paxos dëgjuam një zë mistik që thërriste: Kur të arrish në Liqenin e Butrintit, Pelodës, kujdesu të njoftosh se Perëndia Pani ka vdekur, dhe vazhdon më pas se në Pelodes, deti ishte xham i lëmuar dhe kur u shqiptua mesazhi Pani ka vdekur, u dëgjua një ulërimë rrëqethëse nga mijëra nimfa që rënkonin dhe vajtonin. Flitet për Shën Terini si martirët e parë Ushtarakë - Në Teatrin e qytetit u masakrua në shek.-3 martiri ushtarak “Shën Terini i Butrintit“.

Po në Butrint ndodhet tempulli i perëndisë pellazge Asklepi (ste ka le me pa – sklepa në shqip), me dy dhomat e ndara veçmas për gratë dhe veçmas për burrat, të cilët hipnotizoheshin për qëllime mjekësore apo kurimi, dhe kësaj ndërtese i thuhet nga drejtuesi i Fondacionit që ka qenë dhe ky që po krijohet me ligj të posacëm, z. Richard Rodges, sikundër çdo gjëje tjetër kult helenistik. Tempullit të Asklepit hyut pellazg i thuhet Eskualapit që mos të lidhet me etimonin e fjalës shqipe epire a-asht, sk-ska, le -lene dhe p-pa, pra perëndi apo Hy që ‘sikalane’ njerëzit me pa, ose sklepa shqip, sespe roli i ketij hyu apo doktori të magjishëm ky ishte, që mbasi t’i ndante në dhoma, vec e vec burrat, dhe gratë, sikundër jane dy dhoma edhe sot, iu mbyllte sytë, i hipnotizonte dhe i operonte ose i shëronte me farëra të forta, prej nga vjen edhe fjala farmaci - lëndë që fara m(b)an, mbajnë farëra për shërim.

Butrinti, qytet i fisit Epirot të Kaonëve i banuar që në kohërat parahistorike, fakt historik i njohur.

Natyrisht, një qytet i vjetër, gjatë historisë është pushtuar ose sunduar nga një sërë perandorish, duke përfshirë edhe atë greke dhe romake, por kjo nuk e ndryshon origjinën dhe vërtetësinë e tij. Është një fakt historik i njohur se Buthrotumi ose Butrinti i sotëm, qytet i fisit Epirot të Kaonëve, ka qenë i banuar që në kohërat parahistorike.

Është gjithashtu një fakt i vërtetuar historik se Epirotët (Kaonët, Molosët dhe Dhesprotët) ishin fise ilire, gjuha e tyre ishte një dialekt shqiptar dhe mbreti i tyre i famshëm Pirro (në shqip Piro) është një nga mbretërit ilirë më të njohur. Kjo pjesë e fundit kontestohet nga Greqia moderne për të justifikuar pushtimin e Çamërisë dhe pretendime të tjera. Identiteti historik nuk është e vetmja gjë që u vodh nga Butrinti. Dy statuja të lashta prej mermeri të Artemidës dhe Apollonit, së bashku me shumë gjetje nga gërmimet e mëparshme, u vodhën. Për fat, dy statujat u gjetën në Greqi dhe u kthyen në Shqipëri.

Dyshimi ynë



Hapja e Shqipërisë tërhoqi shumë institucione të huaja të interesuara për të gërmuar në Butrint, por jemi skeptik nëse kanë një synim të sigurtë për të zbuluar të vërtetën, apo për të vënë një vulë greko-romake në këtë vend të madh arkeologjik dhe kulturor shqiptar me rëndësi ndërkombëtare.

Vendimet e UNESKOS

1. Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore duhet të sigurojë që vlerat e tyre universale, duke përfshirë ruajtjen e kushteve të integritetit dhe autenticitetit në kohën e përfshirjes në UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën), janë të qëndrueshme dhe të përmirësuar me kalimin e kohës, siç specifikohen në Operational Guidelines¹ (Udhëzimet Operacionale).
2. “Të gjitha pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore duhet të kenë mbrojtje dhe menaxhim adekuat afatgjatë legjislativ, rregullator, institucional dhe/ose tradicional për të garantuar mbrojtjen e tyre, masat legjislative dhe rregullatore në nivel kombëtar dhe lokal duhet të sigurojnë mbrojtjen e pasurive nga shoqëria, presionet ose ndryshimet ekonomike dhe të tjera që mund të ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe autenticitetin e pasurisë. Shtetet palë duhet gjithashtu të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të masave të tilla.”
3. Pavarësisht se si bëhet, është e qartë se përgjegjësia për mbrojtjen dhe menaxhimin e një pasurie të Trashëgimisë Botërore i takon vendit në të cilin ndodhet; në këtë rast, qeveria shqiptare si pronare e Butrintit ka përgjegjësinë përfundimtare për respektimin e vazhdueshëm të rregulloreve të UNESCO-s.
4. Pra, në vitin 1992, UNESCO e shpalli Butrintin për Vlerat e Jashtëzakonshme Universale [Outstanding Universal Value/Autsending juniversll valju] pjesë e Trashëgimisë Botërore. Ky është klasifikimi më i lartë i mundshëm. Në sqarimin e mëtejshëm thuhet se - Vlerë e jashtëzakonshme kulturore do të thotë rëndësi, aq e jashtëzakonshme, sa që i kapërcen kufijtë kombëtarë dhe që ka rëndësi universale për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të mbarë njerëzimit.
5. Neni 4 i Konventës së Trashëgimisë Botërore të Parisit 1972 shprehet se: Detyra për të siguruar njohjen, mbrojtjen, konservimin, propagandimin dhe përcjelljen për brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, “i **takon në mënyrë ekskluzive shtetit palë**”.
6. Neni 17, thotë se “shtetet Palë duhet të inkurajojnë ngritjen e fondacioneve nacionale publike ose private, qëllimi i të cilave është të vjelin donacione për mbrojtjen e trashëgimisë”.
7. Fryma e ligjit të Unesco-s është që nëpërmjet shesheve arkeologjike të rritet vetëdija dhe identiteti i kombit në rang vendi dhe lokal.

Në rrethanat specifike të Butrintit, parashtrihen konceptet si:

1. Trashëgimia kulturore është gjithashtu shumë filantropike nga



DEA DI BUTRINTO

natyra, e cila me kalimin e viteve ka shkaktuar një prani gjithnjë në rritje të sektorëve jofitimprurës të përfshirë në këtë fushë.

2. Në nivel ndërkombëtar, në përputhje me Konventën e vitit 1972 në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, UNESCO pranoi se disa vende në botë kanë “vlerë të jashtëzakonshme universale” dhe i përkasin trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit.
3. UNESCO gjithashtu themeloi Fondin e Trashëgimisë Botërore për të siguruar burime financiare për ruajtjen dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore, i cili merr të ardhurat e tij nga kontributet e detyrueshme nga shtetet anëtare, kontributet vullnetare dhe donacionet private, si dhe nga shitja e botimeve ose fondeve në mirëbesim, dhuruar nga vende të ndryshme për qëllime specifike.

Ligji i v. 2018 mbi Trashëgiminë kulturore dhe monumentet e kulturës³ - ligj problematik

Në 2017, Ministrja znj. Furxhiu pas takimit me CEON dhe AADF ku merrte pjesë dhe z. Mata shprehet pas kësaj ose para nisjes së punës në Butrint duhet “korniza ligjore”. Kësisoj lindi bashkëpunimi i menduar nga AADF me agjencitë përkatëse qeveritare dhe joqeveritare dhe të tjera, që synonte të sjellë praktikën më të mirë të përdorura diku tjetër nga vendet e Trashëgimisë Botërore, duhet të shihet si një ndërmarrje pozitive – *kuptohet në përputhje me UNESCO-n, e cila ka miratuar Butrintin si vend të Trashëgimisë Botërore*. Edhe pse një pasuri e popullit shqiptar, UNESCO beson se është në interesin më të mirë të komunitetit ndërkombëtar të mbrojtjes së Butrintin si një trashëgimi kulturore për brezat e ardhshëm. Në sipërfaqe, duket sikur ata bënë shumicën e gjërave të duhura thotë një nga antarët e Fondacionit z. Cafo Boga, të cilat duhej t'i bënin, domethënë:

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe ekspertët ligjorë, hartuan Ligjin për Zonat e Mbrojtura (2017) dhe Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (2018). Këto dokumente u miratuan nga qeveria dhe i hapën rrugë hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar.
2. Së bashku me Ministrinë e Kulturës, organizuan një aktivitet për Planin e Menaxhimit të Integruar, ku morën pjesë Ministri i Kulturës, Kryetari i AADF, Michael Granoff, dhe me sa duket aktorë të tjerë kombëtarë. Vendimi u mor për të punësuar Prince + Pearce nga Britania e Madhe, një kompani që me sa duket kishte përvojë të gjerë në hartimin e planeve të menaxhimit të Trashëgimisë Botërore.
3. Me ftesë të Ministrisë së Kulturës, u organizua një takim me përfaqësues nga agjencitë shtetërore, palët e interesuara, ekspertë të trashëgimisë dhe Prince + Pearce për diskutime publike, ku morën pjesë si Ministrja e Kulturës, ashtu edhe bashkëdrejtuesit e AADF.
4. Bashkëdrejtuesit e AADF-së u takuan me përfaqësues nga Qendra e Trashëgimisë Botërore për Evropën dhe Amerikën e Veriut, të cilëve iu bashkua edhe Ambasadori i Delegatit të Përhershëm të Shqipërisë në UNESCO.

³ https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Ligji.nr27-_dt.17-05-2018.pdf

5. Financuar nga AADF dhe në bashkëpunim me Parkun Kombëtar të Butrintit, u organizua në Butrint një takim me një listë të gjerë të aktorëve vendorë nga Saranda, që përfaqësonin zyrtarë shtetërorë dhe vendorë, agjenci dhe përfaqësues të komuniteteve përreth parkut.
6. Më në fund, drafti u përgatit dhe Kryetari i Bordit të AADF-së, në një takim të përcaktuar ia dorëzoi zyrtarisht Ministrit të Kulturës, draftin përfundimtar të Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit. Projekti u financua nga AADF me një kosto prej rreth 250,000 dollarë.



Reagimi ynë

1. Ky fondacion prodhoi Ligjin nr.27/2018 mbi “Trashëgiminë kulturore dhe monumentet e kulturës”, i cili është një ligj problematik. Ndaj, zanafilla e problematikes lidhur me menaxhimin e Butrintit është ky Ligj shqiptar, pas këtij mori shkak marrëveshja,⁴ e cila krijoi fondacionin në fjalë, e cila u miratua me një ligj të posacem.⁵ Vetë ligji i vitit 2018 është në kundërshtim të rëndë me Kushtetuten dhe Konventat në të cilat Shqipëria ka aderuar.
2. Për këtë rast reagon edhe ish-kreu i ICOMOS (UNESCO për sitet dhe monumentet) Giora Solar, nr.1 në botë për menaxhimin e monumenteve ku shprehet: “që donatori të nderhyjë për të ndryshuar ligjin, të paguajë dhe të ndryshojë ligjin e nje sovрани, nuk e kam parë në asnjë vend tjetër në botë”. Pra, ekziston një konflikt i madh interesi. Sipas planit të paguar nga AAFD, Butrintit do menaxhohet nga vetë fondacioni AAFD. Ideja dhe sistemi janë të korruptuara, provë kjo që qeveria nuk dëshiron të krijojë një mekanizëm kombëtar për menaxhim.
3. Ajo që lexuesi nuk mund të vlerësojë është se Bordi i AADF-së, përveç kryetarit, nuk ka pasur asnjë rol në asnjë nga këto hapa dhe as nuk ka parë ndonjë nga këto dokumente.
4. Në Britani dhe kudo nuk do të mund të kalonte kurrë një ligj i tillë pa pasur trajtimin e të paktën këtyre problematikave.

Ne besojmë se:

1. Firma e punësuar për të hartuar planin e menaxhimit nuk kishte ekspertizën dhe kualifikimet e nevojshme për të shkruar një plan të tillë për Butrintin, i cili është një vend mjaft i ndërlikuar dhe gjithashtu shumë i rëndësishëm për kombin.

⁴ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20220427132253all%20dok.pdf>

⁵ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20220412113302Priligj%20Butrinti.pdf>

2. Është seriozisht fyes fakti se plani i menaxhimit i parashikuar nuk ka referencë për asnjë studiues shqiptar që ka punuar në Butrint që nga vitet 1930, por fillon me punën e një arkeologu britanik në vitin 1994.
3. Çështja më shqetësuese është se plani rekomandon që Parku Kombëtar i Butrintit të menaxhohej nga një palë e tretë e pavarur, çka është shumë shqetësuese për këdo interesues të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Kësisoj

Procesi i menaxhimit të Butrintit u rihap përsëri në tetor të vitit 2018, kur u nënshkrua një tjetër marrëveshje për bashkëpunim midis Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim me një financim prej 250 mijë dollarësh prej këtij të fundit. Fondacioni në fjalë qysh në vitet 2013 lloboi që të pregatitej një ligj për monumentet e kulturës që ti hapte rrugë ligjit të sotëm që është thjesht një Ligj preferencial ndaj një shoqërie, në këtë rast Fondacion. Ndaj dhe bërësit e këtij ligji nuk u kujdesën kurrë që:

1. Të kishte më parë thirrje për propozime,
2. Të kishte analiza paraprake,
3. Të kishte studime paraprake, si studim sizmik, studim mjedisor, studime mjedisore deri në ato gjeologjike dhe gjeorrezique.
4. Të kishte grupe interesi me mendimin e tyre.

Por:

1. Modeli i ri i mbikëqyrjes supozohej të siguronte funksione të përmirësuara dhe të mbronte sitin dhe zonat përreth nga ndërhyrja e paautorizuar ose e paligjshme, ndërkohë që ofronte mundësi për komunitetin lokal në një mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar.
2. Këtë fakt ta japin edhe udhëzimet mbikombëtare kuptojmë se ato adresojnë përpjekjet e politikëbërësve dhe operatorëve sesi të garantohet zbatimi efektiv i udhëzimeve mbikombëtare në nivel lokal dhe për çdo monument dhe sesi zonat kulturore të jenë të hapura për publikun? Në këtë kontekst, Menaxhimi Cilësorë i Trashëgimisë Kulturore është një temë në zhvillim”, duke sjellë kështu në fokus edhe sektorin privat.

Ligj 2018 - i hap rrugë Fondacionit të huaj dhe privatëve

Modeli i këtij Ligji nuk është në harmoni me marrëveshjen ndërkombëtare, konventen e UNESCO-s, Paris 1972⁶, ku Parlamenti ynë e ka ratifikuar atë, duke i dhënë prevalencë mbi ligjet e vendit⁷, në kete dokument thuhet se:

1. Në lidhje me sheshet e monumentet e kulturës - ***parësor është shteti*** dhe nuk mund të zhvishet shteti për menaxhimin e një prone publike.
2. Pasuritë kulturore publike administrohen në formë direkte ose indirekte nëpërmjet ***fondacioneve të posaçme të vendit ose të huaja.***

⁶ <https://whc.unesco.org/archive/convention-en.pdf>

⁷ Shih neni 116 të K.R.Sh

3. Neni 172.1 thotë se: “Administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore mund të kryhet edhe nga persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuar nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe personave fizikë ose juridikë privatë, **vendas apo të huaj**.”
4. Po aty theksohet se “Pasuritë kulturore **publike** administrohen në formë direkte ose indirekte nëpërmjet fondacioneve të posaçme.”
5. Ministria e Kulturës pohon se “edhe pse sistemi aktual i menaxhimit ka siguruar i sforcuar mbrojtjen e vlerave kulturore të Parkut, ai nuk është fleksibël, nuk ka arritur pritshmëritë e tij, dhe nuk garanton në perspektivë mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore.
6. Kësisoj, Ministria e Kulturës lidh nevojat për ndryshim në Butrint me nevojat për të sjellë burime të reja financimi, të qëndrueshme dhe afatgjatë dhe qasje të reja menaxhimi për Parkun Kombëtar.
7. Plani i fundit (Ligji i personalizuar), i paguar nga vetë Fondacioni Butrinti – AAFD mendohet se Butrinti duhet të menaxhohet nga një ndërmarrje private. Përfitimi nga kjo mbrojtje do të ishte vetë fondi.

Ligji i miratuar Maj 2022 për menaxhimin e Butrintit sipas ‘një politike të re’

Me këtë ligj vërehet shkelje e nenit 3 të Kushtetutës së Republikës, si dhe bien ndesh me nenet e shpalluar të UNESCO-S, ku pikat alarmante të marrëveshjes së Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për menaxhimin e Butrintit shprehen tekstualisht si më poshtë se:

Neni 4.1 thotë se: Ministria, si përfaqësues i Qeverisë i jep Fondacionit të drejtën ekskluzive për administrimin e Pasurisë Kulturore. “Administrim” nënkupton të drejtat e Fondacionit, përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin, shfrytëzimin, të drejtën për të caktuar dhe mbledhur tarifat, **dhënien në përdorim në të gjitha format**...Tarifat do jenë...11 USD me të drejtën e rritjes deri në 30% të vlerës së indeksuar të inflacionit. Nga ky ligj kupton sesi shteti shqiptar nëpërmejt Ministrisë së vet, asaj të kulturës, përjashton totalisht vetveten dhe dikasteret e veta, duke i dhënë të drejtën e plotë të përdorimit dhe shfrytëzimit të sheshit akeologjik të Butrintit, duke i dhënë me anë të nenit 5.2 të mëposhtëm **gëzimin e plotë dhe të qetë të Pasurisë Kulturore** (neni 5.2. Ministria, deklaron dhe garanton gëzimin e plotë dhe të qetë të Pasurisë Kulturore). Në një kohë që përfshirja e sektorit privat mund të marrë formën e sponsorizimit, donacioneve, partneriteteve dhe menaxhimit pa pronësi.

Neni 9.2 shprehet tekstualisht se: Fondacioni miraton planet vjetore të veprimtarive ekonomike, artistike, turistike dhe kërkimore dhe sipas nenit 17.5 - Të ardhurat, derdhen në llogarinë bankare të Fondacionit. **Kujdes! OJQ nuk kontrollohet nga Kontrolli i Lartë i shtetit!?**

Ndërkohë që **neni 17.6** shprehet se - Fondacioni mund të ofrojë shërbime si kafeteri, ushqim, riprodhim e pasurive kulturore; **Menaxhim diapotekash**, organizim panairesh, pra, cdo objekt të zbuluar, ai dhe vetëm ai do ta menaxhojë, tregtojë, çka e mbështet neni tjetër më poshtë si ai **19.1 ku Fondacioni merr leje** zhvillimore në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë; **lejen e ndërtimit**; leje peizazhi; leje për ndërhyrje në pasuritë kulturore, licenca për projektim zbatim **dhe qarkullim të pasurive të luajtshme (nxjerrjen jashtë shtetit)**.

Ndërkohë që shteti ynë nëpërmjet taksapaguesëve shqiptarë i shtron dhe i gatit të gjitha nevojat për cka i duhet atij – këtij Fondacioni, ku **neni 20.2** shprehet se - **Ministria do të realizojnë Infrastrukturën** për funksionimin e Qendrës së Vizitorëve, **me fonde të buxhetit të shtetit...** Brenda 60 ditëve Ministria transferon në llogarinë bankare të Fondacionit, një shumë të barabartë me fondet e papërdorura dhe të mbartura (*vetëm në vitin 2019 2 milion \$*).

Dhe kjo vazhdon e mbështetet me nënin tjetër **23.3** ku **Fondacioni financohet nëpërmjet grantit 5 milion \$**. Një pjesë (sa?) do disbursohet, në të njëjtën datë me kontributin e Ministrisë, pjesa e mbetur e grantit do të disbursohet në vijim. Vitin e parë Fondacioni do kontribuojë me 0.5%, të të ardhurave vjetore, pra me (20.000 \$)

Dhe më pas vjen neni i nënshtrimit si ai **30.2** ku **Qeveria** nëpërmjet Ministrisë së Kulturës **do të dëmshpërblejë Fondacionin** dhe do ta mbajë Fondacionin të pacënuar, për çdo humbje të çfarëdo lloji që mund të pësojë Fondacioni.

Nga sa më sipër kupton se:

1. Te neni 4/1 i këtij Ligji, Ministria i jep Fondacionin të drejtës Royale, si dhe i jep drejtën e administrimit, pra në këto kushte deklaron dhe garanton gëzimin e plotë dhe të drejtën për të poseduar dhe shfrytëzuar e gëzuar gjithë Parkun Butrint.
2. Vetë Ministria s'ka të drejtë të organizojë, punojë, të marrë pjesë pa marrë leje nga Fondacioni.
3. Në ligj, nuk gjendet dot se cili është raporti në midis Fondacionit dhe efektit të biznesit?
4. Ligji përmban një mungesë të theksuar transparencës që Ministria e Kulturës ka bërë të mundur këtë qasje. As dokumentet e themelimit dhe as marrëveshja e funksionimit nuk janë venë bordit në dispozicion, përveç ndoshta Kryetarit?!
5. Në vetë Ligjin bie dukshëm fryma e trajtimit preferencial ndaj një pale që në këtë rast quhet Fondacion.
6. Shtrohet pyetja? Përse mund të ndodhin këto investime, kur fitimet janë 1.5, në realitet 4 milion euro, dhe as 300 mijë euro nuk përdoren?
7. Parku i Butrintit do të bëhet kështu si themi ne, sepse ne dimë se çfarë bëjmë, ju s'dini se çfarë flisni. Fitimet nga baret dhe restorantet që do të ndërtohen në Butrint nuk do të shkojnë në Amerikë.

Prandaj,

Do të ishte e domosdoshme të mblidheshin që në fillim të gjithë ekspertët dhe palët e interesuara relevante vendore për të punuar në mënyrë proaktive në formulimin e planit dhe më pas të mblidheshin si një.

Ndërkohe që,

Organi më i lartë **Këshilli Kombëtar i Kulturës Materiale** nuk del në asnjë vend, rolin e tij e ka mare me kohe Fondacioni me VKM, Nr 208, dt. 10.4.2019.

Po c'është ky Organ?

Keshilli Kombëtar i Trashëgimise Kulturore Materiale (KKTKM) është organ kolegjal vendimarrës pranë Ministrisë përgjegjës për trashëgimie kulturore. Në kapitullin IV të ligjit për të thuhet se: Këshilli Kombëtar i Trashëgimise Kulturore Materiale, ka keto kompetenca:

- a) Licencën dhe u revokon licencën subjekteve, personave fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimise kulturore, në projekte, zbatim, mbikeqyrje, kolaudim, vlerësim, veprimtari arkeologjike, të arkeologjise së shpëtimit dhe arkeologjise nenujore;
- b) Miratën projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimise kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këto qëllime;
- c) Mbikeqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit; miratën lejet për nderhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme,
- d) dh) Miratën në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve; zonave arkeologjike dhe zonat mbrojtëse të pasurive kulturore;
- e) Miratën, vlerëson, në parim, planin e përgjithshëm dhe të detajuar vendore në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore;
- f) Miratën dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në teritore të njohura ose jo si zona me vlerë arkeologjike;
- g) Miratën planin e zhvillimit të projekteve restauruese e konservuese dhe projektet kërkimore-shkencore të njësisë të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike;

Mesazhi prej këtij dhe për këtë ligj:

Pa një pa dy, duhet ndaluar e drejta e funksionimit, sepse bie ndesh me frymën e Kushtetutës dhe atë të organizmave ndërkombëtare, si UNESCO.

Këndvështrime dhe arsyetimi ligjor

Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se “...identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare... janë bazat e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. Duket e paqarte se si shteti ynë dhe qeveria tentojnë ta mbrojnë këto trashëgimi kombëtare si Butrinti duke përfshirë në menaxhimin dhe administrimin e saj një person i cili haptazi dhe në mënyrë të perseritur, edhe me shkrimi ka mbajtur qëndrimin se Butrinti është një sit grek i cili padrejtësisht i ka mbetur Shqipërisë. Këtu natyrshëm lind pyeta nëse ky Fondacion i krijuar me në krye këto person do të punojnë për promovimin e këtij siti si një pasuri Shqiptare apo si një pasuri Greke.

Neni 17 i Konventës lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1989 parashikon se “Shtetet Palë në këtë Konventë do të marrin në konsideratë ose inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave qëllimi i të cilave është të ftojë donacione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore siç përcaktohet në Nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente.” Duke sikur iniciativa e

qeverise për arritjen e marrëveshjes me AFFD për krijimin e Fondacionit për menaxhimin e Butrintin, e ka keqinterpretuar këtë dispozitë të konventes në fjalë.

Me miratimin e Ligjit nr.27/2018 iu hap rruga krijimit e Fondacioneve të këti lloj, kështu, neni 8/5 parashikon se “Shteti mund të krijojë dhe subjekte juridike, me qëllim vlerësimin/administrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira botërore.” Edhe pse në pamje të parë dket sikur mundesia abstrakte për lejimin e një menaxhimi të tille u krijua. Mbetet ende e paqartë arsyeja pse, një sit efiçnt si ai i Butrintit kishte nevoje ti kalojë në administrim një fondacioni. Ky parashikim është i paqartë, madje edhe pse qevria dhe ministria e linjes nuk e pranon çon drejt një koncesioni të “pagëzuar” ndryshe. Vlerat kulturore janë pasuri publike dhe duhet të gëzojnë mbrojtje shtetërore në interesin më të mirë të qytetarëve të Shqipërisë de kësisoj, përgjesia direkte duhet ti mbetet kurdohere shtetit dhe jo një fondacioni.

Neni 10 pika 6 parashikon se4 “ Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurisë kulturore, sipas pikës 1, të këtij neni, administrohen nga subjekti që administron pasurinë, me qëllim kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve për ruajtjen e mbrojtjen e pasurive kulturore”. Momenti i paqarte është se c’doth me tepricen e të ardhurave të krijuara.

Neni 22 pika 2 parashikon se “Në rast të dëmtimit ose shkatërrimit të pasurisë kulturore për arsye të mospërmbushjes së detyrimeve të tyre, pronarët ose poseduesit e pasurisë kulturore detyrohen ta rivendosin atë në formën e saj origjinale, nëse është e mundur, me parametrat e saj origjinalë hapësinorë, tiparet arkitektonike dhe artistike, brenda një afati kohor që përcaktohet në kushtet e lejes së ndërhyrjes.”. pytja që lind këtu është se po sikur ky fondacion të mos jete në gjedje ta ktheje sitin në gjendjen e meparshme, apo po sikur siti të mos jete me në gjendje të kthehet në gjendjen e meparshme, kush e mban përgjegjesinë dhe si do të veprohet.

Gjithashtu problematik duket se është neni 102 i cilo parashikon Kushtet për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore.

Neni 109 i këtij ligji krijon mundësinë e Tjetërsimit të pasurive kulturore jopublike në pronësi të shtetit.

Neni 171 parashikoi mënyrat e administrimit nder të tjera edhe ate nepermjet një fondacioni

Edhe pse relacioni shoqerues i marrëveshjes se Ministrisë për krijimin e Fondacionit ka një titull për kushtetueshmerinë e marrëveshjes dhe për afrimit me ligjet apo standartes e aquis, mjaftohet me citimin e dy neneve dhe nuk i analizon ato në mnyrë që të kuptohet qartazi kjo kushtetueshmeri e pretenduar.

Në mënyrë telegrafike po citojmë nenet e marrëveshjes që na duken të paqarta dhe/ose probematike:

Neni 5/2/c, 6/5/c, 6/5/d, 6/5/e, 7/4/b, 14/9 e vazhdim, 20 evazhdim.

Për me teper, në kete çështje a një konflikt interesi të dukshem pasi një anetar i Fondacionit ka marrë pjesë në realizimin e projekt ligjit dhe të projekt marrëveshjes.

Mundesitë aktuale për të kundërshtuar këtë vendimmarje të qeverisë janë si me poshtë:

1. Nëse do të konsiderojmë se problematika e lindur do të materializohet nga aktet shoqeruese (të cilat do të konsiderohen si akte individuale) të Ligjit të miratuar se fundmi dhe qëllim do të jetë goditja e këtyre akteve, atëherë do t'i drejtohem Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative,
2. Nëse do të konsiderojmë se problematika e lindur do të materializohet nga aktet shoqeruese, në rastin se këto do të jenë akte normative, do t'i drejtohem Gjykatës Administrative së Apelit,
3. Duket sikur problemi qëndron në vetë projektligjin e fundit të miratuar dhe në vetë marrëveshjen e arritur, kjo pasi vetë këto vijinë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventat e ratifikuara nga shteti ynë. Si rrjedhojë, kjo problematikë hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Për të u adresuar kësaj Gjykatë, është idomosdoshem bashkëpunimi me subjektet e pakushtezuara të cilat legjitimohen në aksesin në Gjykatë.
4. E megjithatë, zanafilla e problemit, mbetet Ligji nr.27/2018. E udhës do të ishte goditja dhe korrëzja e shfuqizimit të këtij ligji, pasi është ky ligji i cili i hap rrugë kësaj forme menaxhimi. Parimisht, duket sikur afati i goditjes së këtij ligji ka kaluar, megjithatë, argumentat të cilat mund të përdoren nuk kanë shteruar.
5. Më tej akoma, po kuptojmë se Ligji, qoftë ky i vitit 2018, qoftë ky i fundit, del në kundërshtim me vendimet e Organizmave ndërkombëtare si UNESCO dhe në këto kushte do t'i drejtohem Gjykatës së Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Pikërisht për këtë po përgatitemi, ku është gjetur studioja ligjore për këtë proces dhe/ose për të gjitha proceset e tjera në shkallët gjyqësore brenda vendit.

Financat nga pjesa e mbajtur, fshehur e planit

Nga pjesa sekrete e planit do investohen 7.5 milionë USD, 40% për konservime, 60% ndërtime të reja, ku rreth 3 milion do të paguhet nga taksat e qytetarëve, nga 5 euro për familje, edhe nga ata që nuk kanë bukë. Le t'i zëbërthojmë këto financime - Tre milion për konservimet. Mashtrim: Konservim është vetë ruajtja e gjendjes, pak llaç, gëlqere, pak gurë dhe kaq. Nisur nga planet e IMK e shumta mund të duhen 70 mijë, ja 100 mijë euro. Dmth për strukturat e reja (hotele, kazino, restorante, bare) i takon 7.3 milionë euro (shprehja 'Hotel Livia' të blihet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit dhe të bëhet pjesë e menaxhimit të Zonës A3, sa më shpejt të jetë e mundur). Bileta do të dyfishohet, 15 euro.

Theksojmë fort se:

1. Monumente të trashëgimisë botërore si Stonehenge, Kulla e Londrës, Versaja Koloseu, janë në pronësi shtetërore dhe drejtohen, administrohen apo menaxhohen përkatësisht nga shteti. Në asnjë rast, menaxhimi i tyre nuk u besohet fondacioneve vendase private, aq më pak të huaja.
2. Studimi i këtij fondacioni ka vite që e quan Butrintin qytet Grek dhe Romak, ndërkohë që Butrinti është kryeqendër e Prasaibve, është herë herë Ilir, por në shumicën e kohës është Epir - Kaon.

3. Bordi prej 5 vetave, dy nga Ministria e kulturës, dy nga Fondi i paanshëm dhe për balancë anglezi - nxënësi i Hadmondit që çdo objekt ilir apo epir në shqipëri e quan helene ose greke dhe sot po ashtu i therret si objekte helenistike.
4. Eshte ky Richard Hodges që nuk rri pa thënë se: Saranda, ky qytet i bukur që ju dha pa të drejtë Shqipërisë nga fuqitë e huaja. Ndërkohë që Epirin e quan digë që ndaloi përmbajtjen e Greqisë Klasike nga barbaria Ilire.
5. Shtrohet pyetja pse Ministria e kulturës dmth Kryeministri kërkon që të sigurojë paanësi me dishepullin e studiuesit filohelen që trarit ilir apo epir i thotë fije dhe fijos helene apo greke i thot tra.

Mendojmë se:

1. Bordi i parashikuar siç është propozuar nuk e ka ekspertizën apo edhe vullnetin për të zbardhur të vërtetën për Butrintin dhe për ta shfaqur atë në Botë si një trashëgimi historike dhe kulturore shqiptare.
2. Është e trishtueshme, sepse me zbatimin e një Plani të Menaxhimit të Integruar të mirë-projektuar dhe të zbatuar mirë, shpresohet se do të bëhej një ‘Roseta Stone’ për vendet e tjera historike dhe kulturore në Shqipëri dhe doli një ‘Trojan Horse-Kalë Troje’ - shprehet me qendrimin e tij kritik ndaj Ligjit dhe këtij fondacioni ish antari i këtij Fondacioni.
3. Ne vazhdojmë të jemi skeptik, nëse kanë një synim të sinqertë për të zbuluar të vërtetën, apo për të vënë një vulë greko-romake në këtë vend të madh arkeologjik dhe kulturor shqiptar me rëndësi ndërkombëtare.

Për sa më sipër

1. Duke qenë se kemi të bëjmë me një ligj që bie ndesh me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Duke qenë se kemi të bëjmë me një Ligj që bie ndesh me vendimet e UNESKOS, të cilat janë të ratifikuara në Parlamentin shqiptar.
3. Duke qenë se kemi të bëjmë me një Ligj që bie ndesh me ligjet e vendit, ku një Fondacioni të huaj i jepet e drejta për privatizim dhe hipotekim;
4. Duke qenë se ky Ligj është financuar nga një Fondacion i caktuar dhe dukshëm bie në sy se vjen si ligj i personalizuar për këtë fondacion dhe enkas, madje;
5. Duke qenë se kryetari i këtij Fondacioni nuk ka një synim të sinqertë për të zbuluar të vërtetën, por për të vënë një vulë greko-romake në këtë vend të madh arkeologjik dhe kulturor shqiptar me rëndësi ndërkombëtare.

Ne i kërkojmë Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Të mos e dekretojë këtë Ligj me pasoja të rënda në historinë e popullit shqiptar, në zhvillimin ekonomik të tij si dhe me qasjen që mund të bëhet për të administruar të gjithë sheshet e tjerë arkeologjik.

REFERENCAT DHE STUDIMET MBËSHTETËSE

- Prof. Dr. Apollon Bace, Kalate Ilire
- Operational Guidelines for the Implementation of the *Ëorld Heritage Convention.*” UNESCO, ËHC.21/01, July 31, 2021.
- Operational Guidelines.” UNESCO.
- Quick History of the National Park Service.” nps.gov. Retrieved May 28, 2022, from: <https://ëëë.nps.gov/articles/quick-nps-history.htm#:~:text=On%20August%2025%2C%201916%2C%20President,those%20yet%20to%20be%20established..>
- The Criteria for Selection.” UNESCO.org. Retrieved May 28, 2022, from <https://ëhc.unesco.org/en/criteria/>.
- Carbone, Fabio. “An insight into cultural heritage management of tourism destinations.” ResearchGate.net. Retrieved May 27, 2022, from: https://ëëë.researchgate.net/figure/Proposed-Theoretical-Approach-to-the-analysis-of-the-Cultural-Heritage-Quality-Management_fig2_309311272.
- Seaman, Bruce Alan. “The Role of the Private Sector in Cultural Heritage.” ResearchGate.net. January, 2013. Retrieved May 27, 2022, from: https://ëëë.researchgate.net/publication/262048135_The_Role_of_the_Private_Sector_in_Cultural_Heritage.
- Seaman, “The Role.”

AKADEMIA „RRËNJËT TONA“

Prof. Ing. Av. Sazan GURI

Dr. Stefan PINGULI

Fred BALAJ

Dod LULI

Av.Kristi KURTI

ALEANCA PËR MBROJTJEN E BUTRINTIT

Aulon KALAJA

Prof. Dr. Apollon BACE

Andi TEPELENA

Av. Redon MEKSI

Av. Dorina RUDA

Av. Kujtim CAKRANI

**Përmbajtja e letrës së deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Ina Zhupa, drejtuar
Presidentit të Republikës në datën 26.05.2022.**

Tiranë, më 26.05.2022

Drejtuar: SH.T.Z. Ilir META
President i Republikës së Shqipërisë

Nga : Znj. Ina Zhupa
Deputete e Kuvendit të Shqipërisë

Lënda: Kërkesë për mosdekretimin e ligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”

Shkëlqesia Juaj Z. President,

Në seancën plenare të ditës së hënë, 23 Maj 2022, Kuvendi miratoi projektligjin “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Në cilësinë e deputetes së Partisë Demokratike të Qarkut Vlorë, përfaqësuese edhe për qytetin e Sarandës, Konispolit dhe Finiqit dhe si deputete relatore e komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik e kam kundërshtuar me argumenta këtë ligj.

Nëpërmjet kësaj letre Ju kërkoj mosdekretimin e këtij ligji bazuar në arsyet e renditura shkurtimisht më poshtë, të cilat shpjegojnë përse ky ligj bie në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë dhe interesin publik.

1- Ligji është antikushtetues sepse bie në kundërshtim me Konventën e Parisit 1972

Konventa e Parisit, për Trashëgiminë Kulturore Botërore, 1972, shprehet se parimi themelor i saj është roli i padiskutueshëm parësor i shteteve anëtare, [“Shtete Palë”], në administrimin e pasurive kulturore dhe natyrore në territoret e tyre. Neni 4 i Konventës shprehet, mëse qartë, se “detyra” [the duty], për të siguruar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe përcjelljen për brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore [...] që ndodhet në territorin e tij i takon

në mënyrë parësore atij Shteti.” Me transferimin e të drejtave të administrimit shteti Palë ‘heq dorë nga këto detyra’ dhe shkel hapur parashikimet e kësaj konvente ndërkombëtare.

Po ashtu, Neni 6 .1, ripohon se “sovrانيتeti i Shteteve në territorin e të cilit ndodhet trashëgimia kulturore dhe natyrore respektohet plotësisht”, dhe “të drejtat pasurore të mbrojtura në legjislacionin kombëtar nuk paragjykohen”. Kurse Neni 6.3, është edhe më eksplisit në përcaktimin e rolit unik dhe të pazevëndësueshëm të Shteteve Palë në rregullimin e statutit juridik dhe menaxhimin apo administrimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke përcaktuar se çdo “Shtet Palë” zotohet të mos ndërmarrë asnjë masë të qëllimshme, [deliberate measure], që mund të dëmtojë direkt ose indirekt trashëgiminë kulturore dhe natyrore, [...] që gjendet në territorin e një Shteti Palë tjetër”.

Nga sa më sipër, Konventa e Trashëgimisë Botërore të Parisit, e cila është dokumenti bazë mbi të cilin janë konceptuar dhe shkruar të gjitha legjislacionet në fushën e trashëgimisë kulturore të vendeve të Bashkimit Evropian, por edhe më gjërë përcakton qartazi se administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore duhet të kryhet ekskluzivisht nga shteti. Në këtë kuptim, dhënia e këtyre pasurive personave privatë apo fondacioneve me pronësi hibride publiko-private vjen në kundërshtim me këtë Konventë, të ratifikuar edhe nga Republika e Shqipërisë më 10 korrik 1989, dhe hyrë në fuqi më 10 tetor 1989.

Duke qënë një konventë e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë çdo ligj që bie në kundërshtim me të, është antikushtetuese. Konkretisht: Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 5, përcakton se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.” Më tej, Neni 116 i Kushtetutës përcakton se, “sipas hierarkisë juridike, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi ndaj ligjeve”.

Hapësira ligjore që kanë shfrytëzuar për kalimin e këtij ligji në parlament, është ligji i “Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë” i ndryshuar me mbështjeten e AADF, që po ashtu është antikushtetues për nenet 171,172,173. Sot nuk mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese pasi kanë kaluar 2 vjet nga miratimi. Por, për të kthyer të gjithë situatën në kushtetueshmëri kam paraqitur një projektligj për ndryshimin e këtyre neneve dhe mbylljen e rrugës që projekte të tilla të vijnë për trashëgiminë tonë kulturore nga privati. Nisma është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, datë 11.05.2022, Nr.1759.

2- Ligji është formë koncensionare, e cili prodhon një model të administrimit privat me të drejta të plota mbi Butrintin.

Butrinti i kalon në administrim 4 personave privat dhe Ministres së Kulturës, duke formuar një bord prej 5 vetësh. Edhe një drejtor ekzekutiv po ashtu person privat. Ministrja e Kulturës është vetëm dy vjet kryetare e këtij bordit, edhe kjo formalisht pasi nuk ka ndonjë të drejtë speciale nga

qënia kryetare. Por as formalisht nuk janë kujdesur që institucioni shtetëror të jetë në kryesimin e bordit.

Butrinti thuhet në marrëveshje jepet në administrim të plotë dhe të gjitha përfitimet menaxhohen nga Fondacioni. Ministria i garanton Fondacionit posedimin dhe gëzimin e plotë dhe të qetë të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme pa asnjë kundërshtim.

Fondacioni e regjistron Butrintin në kadastër sipas shtojcës së marrëveshjes. Sipas Kodit Civil kuptimi i posedimit, sqarohet në nenin 304: “Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.” Pra efektivisht 4 persona privat sundojnë efektivisht Butrintin sipas asaj që parashikon marrëveshja.

Paratë që janë në arkën e Butrintit, aktualisht 2.1 milion dollar sipas Ministres, i kalojnë fondacionit bashkë me Butrintin.

Ndërkohë që Butrinti me këtë fondacion të krijuar, model vetëm shqiptar, i hiqet mundësia që Kontrolli i Lartë i Shtetit të kontrollojë se ç'bëhet me paratë e pasurise publike, sepse fondacioni është privat dhe me të drejtë si çdo privat nuk auditohet nga KLSH. Në statutin e këtij fondacioni. pika 26.5 e statutit thuhet se: “KLSH-ja nuk ka objekt auditimi paratë që mblidhen në Butrint”, sepse është privat dhe janë në të drejtën e tyre përderisa Shteti Shqiptar po e dorëzon me ligj.

Fondacioni që do të zbatojë menaxhimin justifikon marrjen e Butrintit për 10 vjet, me grantin 5 milion dollarë që do të ofrojë partneri themelues, e cila është sigurisht arsye e pamjftueshme për të dhënë një pasuri kombëtare me koncension.

Së pari, Butrinti për 10 vjet parashikohet të gjenerojë 60 milion dollarë. Së dyti fondacioni për Butrintin në 1993 i themeluar nga lordi Rothchild dhe lordi Sainsbury funksionoi në vitet më të vështira në Shqipëri, dha kontributin financiar, dhe nuk kërkoi ndonjëherë që ta merrte Butrintin as administrim, menaxhim apo edhe më pak të regjistruar në Kadastër. Gjithashtu Fondacioni Amerikan për pasuritë nënujore RPM Nautical Foundation ka dhënë 4 milionë euro për kërkime për pasuritë nënujore në Butrint, por nuk ka kërkuar kurrë që të marrë territorin nënujor në administrim. Pra nuk është arsye e mjaftueshme që shteti shqiptar për 5 milionë dollarë të japë me koncension Butrintin që gjeneron 60 milionë dollarë për 10 vitet e marrëveshjes.

3- Modelet e paraqitura nga ministria si referencë për menaxhimin e Butrintit nuk kanë asnjë të përbashkët me Ligjin. Ky është një model që nuk ekziston në asnjë vend të botës.

Katër modele janë paraqitur si modele të njëjta menaxhimi nga Ministria: Versaja, Pompei, Stone Age-British Museum dhe Muzeu Egjiptian i Torinos.

- a. Modeli Shqiptar ka 3 përfaqësues privat dhe 2 përfaqësues të supozuar të shtetit
- Modeli i Muzeut Egjiptian të Torinos ka 4 përfaqësues shteti dhe 2 privat
 - Modeli Pompei është institut brenda Ministrisë së Kulturës me autonomi speciale.
 - Modeli i Versajës ka 18 përfaqësues në bord nga të cilët 14 shtetëror dhe 4 privat.
 - Modeli i Stone Age ka 25 përfaqësues të caktuar nga shteti, dhe ka gjithashtu një strukturë të quajtur Bord Besimi që ka personalitete dhe përfaqësues privat që kontribuojnë financiarisht për muzeun (charity).
- b. Modeli shqiptar pretendon se ka dy përfaqësues shtetërorë, në minorancë, Znj. Elva Margariti dhe arkeologun Anglez Richard Hodges, që së pari nuk janë në kapacitetin e tyre shtetëror, por si individë dhe së dyti, Z. Hodges nuk mban asnjë funksion shtetëror në Republikën e Shqipërisë. Në katër modelet e tjera, përfaqësuesit mazhoritar të shtetit, nuk janë të caktuar nominalisht por me funksione shtetërore.
- c. Modeli shqiptar ka hequr fare pushtetin lokal, pavarësisht se pretendon në relacion që ka ndjeshmëri për rolin e trashëgimisë kulturore në komunitete. Të katërta modelet e tjera kanë përfaqësim lokal primar në fondacion.

Gjithashtu, pretendimi se modeli është i bazuar në eksperiencën Amerikane, vetë ish kongresmeni Joe Diguardi i ka dërguar një letër publike Kryetares së Kuvendit Znj. Lindita Nikolla dhe i bën thirrje të mos miratojnë këtë ligj si në kundërshtim me çdo praktike ndërkombëtare.

Ne konstekstin e modeleve ai shkruan: “Me të vërtetë, ju mund të keni dijeni se parqet tona shumë të vlerësuara në Amerikë menaxhohen ekskluzivisht dhe vetëm nga Shërbimi Kombëtar i Parqeve {National Park Service}, një agjenci brenda Departamentit të Punëve të Brendshme të Qeverisë Amerikane. Në menaxhimin e tyre nuk përfshihen as fondacone private, as partneritete publike private, dhe as ndonjë model i ri apo “hibrid”.

4- Ligji ndan në dy pjesë menaxhimin e parkut, në kundërshtim me përcaktimet e UNESCO-s për menaxhimin si një i tërë. Kjo ndarje hap rrugë për ndërtime brenda dhe jashtë zonës A3.

Qyteti antik i Butrintit u shpall për herë të parë monument kulture në vitin 1948; në 1999 u regjistrua në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s; në 2003 kompleksi ligatinor, përfshirë dhe pjesën e lagunës dhe zonën bregdetare të Butrintit – Kepin e Stillos – u shpallën Zonë Ramsar dhe Park Kombëtar (Kategoria II e IUNC-it për Kategorinë e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura).

Për herë të parë ndahet menaxhimi i qytetit antik nga menaxhimi i parkut kombëtar, ndërkohë që koncepti i UNESCO-s është lidhja integrale e dy pjesëve. Nisur edhe nga fakti që qeveria shqiptare me vendim VKM Nr. 59, datë 26.1.2022, Fletore zyrtare nr. 16-2022, vendosi të redukojë

sipërfaqen e zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Butrintit nga 9.424,2 ha në 8.622,2 ha ngre dyshime për ndërtime në zonën buferike të parkut. Sipas hartës bashkëngjitur vendimit të qeverisë për Butrintin një sipërfaqe prej rreth 800 ha nga Manastiri, Gjiri i Hartës dhe deri në kufirin jugor tek Gjiri i Pemës së Thatë, nuk përfshihet më në statusin e zonës së mbrojtur, duke i hapur rrugën ndërtimeve dhe aktiviteteve ekonomike në atë zonë.

Nga ana tjetër sipas kësaj marrëveshje me fondacionin privat, rezulton që ndërtimet në këtë zonë më rëndësi kombëtare kulturore dhe historike, do zhvillohen biznese që nuk kanë asnjë lidhje as me arkeologjinë, as me trashëgiminë dhe as me gërmimet për zbulime të reja. Plani i Biznesit, që përmendet vazhdimisht në marrëveshje, parashikon përfitime private të bizneseve, që do shkojnë në xhepat e individëve që do shfrytëzojnë për këtë një pasuri kombëtare dhe të trashëgimisë botërore.

Ndërtimet në Butrint ka qenë një plan i nisur nga qeveria shqiptare në vitin 2017 ku parashikohej ndërtimi i nje bari (lokal) por ishte ndërhyrja e Dr. Mechtild RÖSSLER, Director of the UNESCO World Heritage Centre and the Heritage Division me nje letër urgjente i kërkonte qeverisë shqiptare në mënyrë eksplicite të ndalte menjëherë çdo punim dhe ndërhyrje në Butrint. Letra e mbërritur nga UNESCO është dërguar për autoritetet shqiptare më datën 9 tetor 2017. Ndërsa atëherë falë ndërhyrjes së UNESCO-s u ndalua plani i ndërtimit, tani plani i ndërtimit është faza e dytë pasi ti jepet fondacionit privat fillimisht dhe më pas shteti të mos mbajë as përgjegjësi përpara UNESCO-s.

Në plan shkruhet: “Kompleksi i ndërtesave brenda dhe rreth ‘Shtëpisë së Doganës’ në brigjet e Kanalit të Vivarit përballë kalasë së ‘Ali Pashës’, ndërtuar mbi themelet e një vile romake buzë detit, ofron pamje spektakolare nga Kanali i Vivarit, Gjiri i Butrintit dhe deti Jon. Jo më larg se 1.5 km nga qendra e propozuar e vizitorëve, siti mund të shndërrohet për akomodim hoteli. Ai duhet të merret në konsideratë si një opsion për Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit, pasi kthimet në atë hotel, me restorante dhe shërbime të tjera, mund të jenë thelbësore dhe do të garantonin një të ardhme të qëndrueshme për sitin, nën menaxhimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit”

Në planin e menaxhimit po ashtu parashikohet ndërtimi brenda Butrintit. “Mirëqenia e Zonës A3 dhe Parkut Kombëtar përreth tij nëpërmjet largimit të mbetjeve plastike dhe të tjera, punësimit të banorëve vendas si udhërrëfyes, varkëtarë dhe zejtarë dhe rritjes së të ardhurave të banorëve vendas nëpërmjet ngritjes së hoteleve, restoranteve, bareve dhe strukturave të ngjashme”, thuhet në marrëveshje.

Duket qartë që ndërtimet janë parashikuar të shumta brenda qytetit antik por edhe brenda parkut kombëtar, me heqjen e mbrojtjes të pjesëve të tij për ndërtimin e resorteve sic denoncon me prova media BIRN.

5- Mungesa e dokumentacionit nga UNESCO dhe ICOMOS

Një projekt i tillë duhet jetë i konsultuar edhe i paraqitur Kuvendit dhe Presidentit me dokumentacionin përkatës nga UNESCO. Duke qenë se Butrinti është në listën e trashëgimisë botërore që nga 1999. Asnjë dokument i tillë nuk është në Kuvendin e Shqipërisë dhe pse të kërkuara nga unë, në cilësinë e deputetes.

Në emisionin televiziv Opinion, shfaqën një letër që pretendohet që është rekomandimi pozitiv i UNESCO-s për Butrintin, letër në të cilën nuk ka asnjë element të lidhur me marrëveshjen e menaxhimit e ligjin në fjalë.

E para është data, kjo letër ka ardhur më 28 shkurt 2020 ndërkohë fondacioni për të cilin ne flasim dhe fondacioni për të cilin duhet të kishin marrë miratimin nga UNESCO është krijuar më 22.07.2021 pra UNESCO nuk shprehet dot për një fondacion që do të krijohet një vit më pas që është privat dhe aq më tepër që kjo letër nuk është as rekomandim pozitiv, por një kërkesë për informacion që i bën UNESCO qeverisë shqiptare: “Mbasi ju takuam Ju dhe ekspertët e AADF ne kemi nevojë për sqarime të mëtejshme”

Informacioni i parë që kërkojnë është: “Specifikoni emrin e strukturës shtetërore”, *nënvizoj strukturës shtetërore*, “në trupën qeveritare e cili do të jetë për menaxhimin e pasurisë botërore të Butrintit.” Pra UNESCO kërkon të specifikojë kush do të jetë struktura qeveritare, që të lë të kuptosh se gjatë takimit as Ministria as AADF nuk kanë shpjeguar krijimin e OJF-së.

6- Ligji rrezikon historinë shqiptare dhe identitetin kombëtar shqiptar.

Butrinti nuk është thjesht një vend arkeologjik për t’u vizituar, por është historia jonë, është identiteti jonë dhe historia e identiteti nuk mund të jepet me koncension.

Në planin e menaxhimit janë zhdukur studiuesit shqiptar dhe jo vetëm kaq, autori i planit dhe njëkohësisht anëtar i bordit të këtij fondacioni Richard Hodges, ka shkruajtur jo vetëm në veprat e veta por edhe në dokumentin zyrtar të menaxhimit 10 vjeçar të Butrintit, që Butrinti është qyteti i një kolonie greke.

Nuk dua të shtoj asgjë më shumë në këtë pikë sesa shkrimi i cituar i një nga arkeologëve tanë më të vyer, anëtar i Akademisë së Shkencave, si Z. Neritan Ceka:

“Duke paraqitur një dokument publik, studio duhet të kishte qenë e kujdesshme në paraqitjen e pjesës historike, që dominohet nga një megallomani anglosaksone (ndjesë për metaforën!), sipas së cilës Parku Arkeologjik i Butrintit është vepër e Fondacionit Butrinti që punoi atje në vitet 1993-2012, duke reduktuar në disa rreshta kontributin e misionit arkeologjik italian të drejtuar nga L. M.

Ugolini dhe asistuar nga H. Ceka, që zbuloi pjesën kryesore të monumenteve, punën e arkeologëve shqiptarë të Institutit të Arkeologjisë D. Budina, S. Islami, S. Anamali, N. Ceka, K. Lako, Dh. Condi, B. Muka që drejtuan ekspeditat kërkimore nga 1958-2019, apo punën e historianëve të arkitekturës dhe restauratorëve të Institutit të Monumenteve K. Zheku, N. Ceka, Gj. Karaickaj, A. Meksi, A. Baçe, që kanë punuar në Butrint gjatë së njëjtës periudhë. Personalisht kam drejtuar krijimin e Parkut Arkeologjik të Butrintit në vitet 1969-1975, kur kam qenë punonjës i Institutit të Monumenteve dhe parku që kemi sot, me përjashtim të muzeut, është krijuar i gjithi në atë periudhë, që nga rrethimi, porta, rruginat e lëvizjes, restaurimi i skenës së teatrit, tempullit të Asklepit, termeve romake, nymfeut, etj. Po ashtu, kam drejtuar ekspeditën arkeologjike shqiptare-greke në vitet 1991-1992 dhe ekspeditën e Forumit në vitet 2004-2005. Ndërsa unë kam qenë autor i krijimit të parkut arkeologjik brenda rrethimit, i detyrohet A. Tares përfshirja në territorin e Parkut edhe të pjesës ambientale dhe vendosja e renxhësive, pa të cilën Parku arkeologjik sot do të ishte i rrethuar nga dhjetëra hotele, restorante dhe banesa. Është jo vetëm joetike, por krejtësisht megallomane mungesa e çdo referimi ndaj kontributeve shkencore e menaxheriale shqiptare për Butrintin në listën bibliografike, ku mund të gjesh citime si: Bescoby et alii, Shenjtë dhe mëkatarë (pa datë dhe vend botimi; al në vend të alii), apo Hernandez D. R; Mitchell, I.; Varrezat perëndimore: vrojtim arkeologjik i varreve romake përgjatë Kanalit të Vivarit, Butrint 4. Oxbow books (Pa datë! dhe përse shërben???), citime që nuk kanë të bëjnë aspak me përmbajtjen e dokumentit, por evidentojnë diletantizmin e hartuesve.

Diletantizmi dhe megallomania bëhen komprometuese për dokumentin veçanërisht për termat e përdorura kuturu, por me rrezikun e interpretimit politik. Butrinti dhe qytetërimi i tij cilësohen grek dhe romak, ndërkohë që Butrinti nuk është koloni helene si Apollonia, Dyrrahu dhe Orik, që cilësohen nga autorët antikë dhe historia moderne si greke. Ato burime dhe mbishkrimet na dëshmojnë se është kryeqytet i prasaibëve, kaon dhe epirot (në se MK mendon se epirotët ishin grekë, le ta dëshmojë, se vetë grekët nuk kanë arritur). Po kaq diletante është përfshirja e të gjithë mureve antike të qytetit nën termin helenistik, që cilëson periudhën 335- 30 p. Kr., ndërkohë që në muret e Butrintit ka një periudhë arkaike të shek. VII p. Kr., klasike të shek. V p.Kr, klasike të vonë të fillimit të shek. IV p. Kr, ndërsa periudha helenistike ka vetëm dy rindërtime të kufizuara dhe nuk gjendet fare në akropol, ku e vendosin hartuesit e dokumentit. Kjo nuk është vetëm me rëndësi shkencore, por edhe për punën konkrete të vlerësimit turistik, konservimit e restaurimit, mbi bazën e teknikave të secilës periudhë (metaforikisht do të ishte sikur të vlerësoje një grua të bukur bionde si midis të tridhjetave dhe shtatëdhjetave!”

I nderuar Z. President,

Ne permblledhja te arsyeve jo shteruese per antikushitetueshmerine e ketij ligji, jo vertem ne germe por edhe frymen e Kushtetutes se Shqiperise, historia dhe identiteti nuk mund te jepet me koncesion tek një privat. Në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk ka miq dhe armiq të përjetshëm, ka interesa shtetërore dhe Ju jeni autoriteti shtetëror garant që të mbron interesat e popullit Shqiptar.

Për sa më sipër ngelem e hapur për informacione shtesë që mund të nevojitet dhe jam e bindur që pozicionimi juaj publik si mbrojtës i Kushtetutës, i sovranitetit- në këtë rast sovranitetit kulturor shqiptar, dhe interesit publik do të mbizotërojnë në këtë vendimarrje.

Me respekt,

Dr. Ina Zhupa

Deputete e Kuvendit të Shqipërisë

Përmbajtja e qëndrimeve të publikuara në mediat elektronike e z. Cafo Boga

Cafo Boga: Saga e Butrintit⁸

Vëzhgimi dhe roli im personal si ish-anëtar i Bordit të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim

Në një artikull që shkrova kohët e fundit, i cili u botua në disa gazeta dhe media online në Shqipëri, unë ofrova një përmbledhje të pjesëmarrjes time me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve (AAEF) edhe me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF).

Gjithashtu u përpoqa të nënvizoja arritjet në përmbushjen e objektivave të misionit të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në të cilat unë së bashku me drejtorët e tjerë të emëruar nga Presidenti Clinton, luajtëm një rol kryesor. Për më tepër, ai artikull kishte për qëllim të hidhte dritë mbi largimin tim dhe gjithashtu të shërbente si një lamtumirë për ata, që kanë vlerësuar kontributet e mia gjatë 25 viteve të kaluara. Duke folur për projektet e ndryshme të ndërmarra nga Fondi dhe Fondacioni ndër vite, përmenda edhe angazhimet tona në Parkun Kombëtar të Butrintit, i cili është bërë temë e nxehtë në mediet shqiptare këto ditë dhe vazhdon të jetë një sage, që nuk dëshiron të largohet. Në fakt, pas publikimit të artikullit tim të mëparshëm, më kanë kontaktuar dhe më kanë kërkuar të shfaqem në programet televizive dhe mediat në Tiranë, gjë të cilën e kam refuzuar me dashamirësi. Për këtë dhe arsye të tjera, u ndjeva i detyruar të zgjerohem në këtë temë, bazuar në memoriet e mia të ngjarjeve dhe shënimeve që kam në dispozicion.

Siç thuhet në artikullin e sipërpërmendur, “Fondacioni filloi me një Plan Menaxhimi të Integruar për Zonën e Trashëgimisë Botërore të Butrintit si një nga parqet më të rëndësishme të Shqipërisë dhe më e vështira për t’u zbatuar.

Pas shumë kthesave dhe punës shumë të mundimshme, plani u zbatua dhe do të përdoret si prototip për objekte të tjera të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike, si Kompleksi i Amfiteatrit të Durrësit.” Unë gjithashtu përmenda “se ky projekt ka shkaktuar shumë polemika, të cilat vazhdojnë edhe sot, për shkak të rolit të Fondacionit dhe mënyrës se si u zbatua” dhe se “bordit nuk iu prezantuan të gjitha faktet dhe dokumentet në lidhje me këtë

⁸<https://www.politiko.al/e-tjera/cafo-boga-saga-e-butrintit-i461562>
https://telegraf.al/aktualitet/cafo-boga-vazhdon-saga-lidhur-me-butrintin/?fbclid=IwAR2YoKbvX7YVwBDjxM7JkqxOkvlpMN6nyc_8n3XPA_1oI6SUYKhEgCi-Mg8
<https://telegrafi.com/cafo-boga-shqiptari-qe-kaperceu-te-gjitha-barrierat-dhe-realizoi-nje-histori-suksesi-ne-amerike/>

projekt; përndryshe, mund të ishin ndalur më thellë në atë projekt dhe ndoshta do të kishim vepruar ndryshe. Mungesa e transparencës dhe keqkuptimi luajti një rol në të.”

Nëse kujtesa ime më shërben mirë, ne vendosën të bënin diçka në Butrint pas një vizite të bordit në zonën e trashëgimisë, ndërsa AAEF ishte ende funksionale. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj zone të trashëgimisë dhe gjendjen e punëve të ndërmarra nga aktorë të shumtë pa shumë koordinim apo një plan koherent, bordi arriti në përfundimin se ne duhet të zhvillojmë një Plan gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Integruar. Prandaj, bashkëdrejtuesve të AAEF-së iu kërkua të përgatisnin një propozim dhe pasi u miratua ata kontraktuan një firmë konsulente nga Izraeli për të hartuar projektin. Edhe pse u bë një pagesë e pjesshme, për një arsye apo një tjetër, ky projekt nuk u realizua kurrë. Unë mendoj se dështimi i tij ishte për shkak se ligjet ekzistuese nuk ishin të favorshme për një plan të tillë. **Megjithatë, AAEF bëri disa përmirësime fizike në Butrint, si instalimi i një sistemi elektronik të biletave, etj.** Dua të theksoj se AAEF në bashkëpunim me administratën e asaj kohe (të kryeministrit Berisha) nënshkroi një memorandum mirëkuptimi, i cili u miratua nga Parlamenti. Në këtë memorandum thuhej se 95% e të ardhurave nga shitja e biletave do të depozitoheshin në një llogari të caktuar për zonën e Butrintit, dhe jo në destinacionin e mëparshëm, gjegjësisht në Ministrinë e Financave. Ndërkohë, afati i aktiviteteve të AAEF skadoi dhe andaj u krijua një organizatë e trashëguar (AADF). Pasi të vinte në funksion, bordi rishikoi projektin e parashikuar të Butrintit dhe menaxhmenti përgatiti një propozim të ri. Bordi miratoi konceptin dhe buxhetet për një Plan Menaxhimi të Integruar, **dhe për të ndihmuar Ministrinë e Kulturës në hartimin e dokumenteve të nevojshme ligjore.** Së bashku, kjo ishte paramenduar të krijonte një model të qëndrueshëm në menaxhimin e vendeve të trashëgimisë me vlera unike kulturore dhe natyrore, që mund të adoptohen dhe zbatohen në disa zona të tjera në Shqipëri. Për më tepër, modeli i ri i mbikëqyrjes supozohej të siguronte funksione të përmirësuara dhe të mbronte sitin dhe zonat përreth nga ndërhyrja e paautorizuar ose e paligjshme, ndërkohë që ofronte mundësi për komunitetin lokal në një mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar.

Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore duhet të sigurojë që vlerat e tyre universale, duke përfshirë ruajtjen e kushteve të integritetit dhe autenticitetit në kohën e përfshirjes në UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën), janë të qëndrueshme dhe të përmirësuar me kalimin e kohës, siç specifikohen në Operational Guidelines (Udhëzimet Operacionale). “Të gjitha pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore duhet të kenë mbrojtje dhe menaxhim adekuat afatgjatë legjislativ, rregullator, institucional dhe/ose tradicional për të garantuar mbrojtjen e tyre, masat legjislative dhe rregullatore në nivel kombëtar dhe lokal duhet të sigurojnë mbrojtjen e pasurive nga shoqëria, presionet ose ndryshimet ekonomike dhe të tjera që mund të ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale, duke përfshirë integritetin dhe autenticitetin e pasurisë. Shtetet palë duhet gjithashtu të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të masave të tilla.”

Pavarësisht se si bëhet, është e qartë se përgjegjësia për mbrojtjen dhe menaxhimin e një pasurie të Trashëgimisë Botërore i takon vendit në të cilin ndodhet; në këtë rast, qeveria shqiptare si pronare e Butrintit ka përgjegjësinë përfundimtare për respektimin e vazhdueshëm të rregulloreve të UNESCO-s.

Në Shtetet e Bashkuara, ekzistojnë tre lloje të pasurive të trashëgimisë kombëtare: Parqet Kombëtare, Monumentet Kombëtare dhe Zonat e Trashëgimisë Kombëtare, të gjitha të krijuara nga Kongresi. Parqet Kombëtare dhe Monumentet Kombëtare janë toka në pronësi dhe menaxhim federal, të administruara dhe operuara nga Shërbimi i Parkut Kombëtar, i themeluar në vitin 1916 nga Presidenti Woodrow Wilson, "...si një zyrë e re federale në Departamentin e Brendshëm përgjegjëse për mbrojtjen e 35 parqeve kombëtare dhe monumentet e menaxhuara më pas nga departamenti dhe ato që ende nuk janë krijuar. Zonat e Trashëgimisë Kombëtare nuk janë tokë në pronësi ose menaxhim federal, përkundrazi, ato menaxhohen nga qeveritë shtetërore ose organizatat jofitimprurëse ose korporatat e tjera private. Shërbimet e Parkut Kombëtar ofrojnë një rol këshillues dhe planifikim teknik dhe asistencë financiare të kufizuar.

Si koncept, trashëgimia kulturore është gjithashtu shumë filantropike nga natyra, e cila me kalimin e viteve ka shkaktuar një prani gjithnjë në rritje të sektorëve jofitimprurës të përfshirë në këtë fushë. Për shembull, National Trust for Historical Preservation (Trusti Kombëtar për Mbrojtjen Historike) në Shtetet e Bashkuara është një organizatë jofitimprurëse e financuar privatisht, roli i së cilës është të bëjë një përpjekje për ruajtjen e vendeve me rëndësi kulturore dhe të rrisë vizibilitetin e tyre; prandaj shumë prej këtyre siteve historike menaxhohen nga organizata partnere jofitimprurëse dhe për shkak të statusit të tyre jofitimprurës, këto organizata mund të mbledhin para përmes kontributeve bamirëse, tarifave të anëtarësimit dhe shitjes së biletave.

Në nivel ndërkombëtar, në përputhje me Konventën e vitit 1972 në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, UNESCO pranoi se disa vende në botë kanë "vlerë të jashtëzakonshme universale" dhe i përkasin trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit. UNESCO gjithashtu themeloi Fondin e Trashëgimisë Botërore për të siguruar burime financiare për ruajtjen dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore, i cili merr të ardhurat e tij nga kontributet e detyrueshme nga shtetet anëtare, kontributet vullnetare dhe donacionet private, si dhe nga shitja e botimeve ose fondeve në mirëbesim, dhuruar nga vende të ndryshme për qëllime specifike.

Fabio Carbone vëren se globalizimi ka sjellë shumë ndryshime, "Kultura konsiderohet si shtylla e katërt e qëndrueshmërisë dhe dialogu dhe mirëkuptimi ndërkulturor është një çështje gjithnjë e më e rëndësishme. Në këtë kontekst, ruajtja, menaxhimi dhe rritja e trashëgimisë kulturore është më shumë se kurrë në qendër të debateve ndërkombëtare, si dhe aleanca e saj

me turizmin. Udhëzimet mbikombëtare adresojnë përpjekjet e politikëbërësve dhe operatorëve, por si të garantohet zbatimi efektiv i udhëzimeve mbikombëtare në nivel lokal dhe për çdo monument dhe zonë kulturore janë të hapura për publikun? Në këtë kontekst, Menaxhimi Cilësorë i Trashëgimisë Kulturore është një temë në zhvillim”, duke sjellë kështu në fokus sektorin privat.

Për më tepër, sipas Bruce Alan Seaman nga Universiteti Shtetëror i Georgia-s (Xhorxhias), fushëveprimi i përfshirjes së sektorit privat në ruajtjen e trashëgimisë është i gjerë, megjithëse shumë i paqëndrueshëm në vende me perspektiva të ndryshme mbi rolet relative të shtetit dhe tregut të lirë, por dallime të tilla duket se po ngushtohen. Për më tepër, ai vuri në dukje se “Ekziston një konsensus në rritje që sektorët privatë luajnë një plotësues jetik për rolin tradicional të sektorit publik në ruajtjen e trashëgimisë dhe se partneriteti privat-publik do të vazhdojë të zgjerohet.” Roli që luan sektori privat në qëndrueshmërinë e trashëgimisë kulturore u themelua mirë dhe u konfirmua në forumin ndërkombëtar për privatizimin e trashëgimisë kulturore në Catania, Itali, në vitin 2007. Përfshirja e sektorit privat mund të marrë formën e sponsorizimit, donacioneve, partneriteteve, menaxhimit pa pronësi apo deri te privatizimi i plotë, duke kombinuar pronësinë, zhvillimin dhe administrimin. **Duhet të theksohet se ekziston një dallim i qartë midis sponsorizimit të korporatave (përfitimprurëse ose jofitimprurëse) dhe partneriteteve, gjë që në realitet nuk është gjithmonë e qartë.** Ndërsa donacionet nga individë, fondacione ose korporata nuk janë të përsëritura dhe përfshijnë pak ose aspak angazhim ndaj qëllimeve të organizatave marrëse, në të kundërt partneritetet përfshijnë jo vetëm financim, por angazhime financiare për burimet e ardhshme të punës dhe kapitalit dhe madje asistencë menaxheriale. **Në lidhje me privatizimin e trashëgimisë kulturore, një çështje e cila është ende shumë e debatuar mes studiuesve dhe aktorëve të ndryshëm, vende të ndryshme kanë zhvilluar modele dhe qasje të ndryshme kombëtare.**

Bazuar në atë çka u citua më sipër, është e qartë se bashkëpunimi i menduar nga AADF me agjencitë përkatëse qeveritare dhe joqeveritare dhe të tjera, që synonte të sjellë praktikën më të mira të përdorura diku tjetër nga vendet e Trashëgimisë Botërore, duhet të shihet si një ndërmarrje pozitive – **kuptohet në përputhje me UNESCO-n, e cila ka miratuar Butrintin si vend të Trashëgimisë Botërore.** Edhe pse një pasuri e popullit shqiptar, UNESCO beson se është në interesin më të mirë të komunitetit ndërkombëtar të mbrojtë Butrintin si një trashëgimi kulturore për brezat e ardhshëm. Gjithashtu, shqiptarët e kuptojnë se ruajtja e trashëgimisë kulturore është një përgjegjësi e gjeneratave dhe se çdo brez në tranzicion duhet të ndërtojë mbi njohuritë e fituara dhe avancimin për të mirën e të gjithë shoqërisë.

Megjithatë çka u fol, as bordi dhe as menaxhmenti i AADF nuk kishin njohuri apo përvojë të gjerë në fushën e ruajtjes ose menaxhimit të zonave arkeologjike dhe të trashëgimisë kulturore. Prandaj Bordi miratoi vetëm konceptin dhe buxhetin për bashkëdrejtuesit për të një studim dhe kërkim të thelluar, **si dhe punësoi konsulentët e**

nevojshëm për të ndihmuar në përgatitjen e draftit të Planit të Menaxhimit të Integruar.

Bordi autorizoi gjithashtu bashkëdrejtuesit të vizitojnë disa vende të njohura të trashëgimisë në Evropë për të mësuar se si vendet e tjera i menaxhojnë ato. Ishte përgjegjësi e bashkëdrejtuesve që të ndërmerrnin hapat e nevojshëm në bashkëpunim me aktorët e kaluar dhe të tanishëm dhe të dilte me draftin më të mirë të Planit të Menaxhimit të Integruar. Për të mos qenë të tepërt, veprimet e bashkëdrejtuesve përshkruhen në faqen e internetit të AADF, nën Eko-Turizëm: Plani i Menaxhimit të Integruar të Butrintit.

Në sipërfaqe, duket sikur ata bënë shumicën e gjërave të duhura të cilat duhej t'i bënin, domethënë:

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe ekspertët ligjorë, hartuan Ligjin për Zonat e Mbrojtura (2017) dhe Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (2018). Këto dokumente u miratuan nga qeveria dhe i hapën rrugë hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar. **Më duhet të them se kam qenë gjithmonë i matur në lidhje me marrjen e një roli të drejtpërdrejtë në hartimin e ligjeve të vendeve, pasi kjo është përgjegjësi e qeverisë.**
- Së bashku me Ministrinë e Kulturës, organizuan një aktivitet për Planin e Menaxhimit të Integruar, ku morën pjesë Ministri i Kulturës, Kryetari i AADF, Michael Granoff, dhe me sa duket aktorë të tjerë kombëtarë. Vendimi u morr për të punësuar Prince + Pearce nga Britania e Madhe, një kompani që me sa duket kishte përvojë të gjerë në hartimin e planeve të menaxhimit të Trashëgimisë Botërore.
- Me ftesë të Ministrisë së Kulturës, u organizua një takim me përfaqësues nga agjencitë shtetërore, palët e interesuara, ekspertë të trashëgimisë dhe Prince + Pearce për diskutime publike, ku morën pjesë si Ministrija e Kulturës, ashtu edhe bashkëdrejtuesit e AADF.
- Bashkëdrejtuesit e AADF-së u takuan me përfaqësues nga Qendra e Trashëgimisë Botërore për Evropën dhe Amerikën e Veriut, të cilëve iu bashkua edhe Ambasadori i Delegatit të Përhershëm të Shqipërisë në UNESCO.
- Financuar nga AADF dhe në bashkëpunim me Parkun Kombëtar të Butrintit, u organizua në Butrint një takim me një listë të gjerë të aktorëve vendorë nga Saranda, që përfaqësonin zyrtarë shtetërorë dhe vendorë, agjenci dhe përfaqësues të komuniteteve përreth parkut.
- Më në fund, drafti u përgatit dhe Kryetari i Bordit të AADF-së, në një takim të përcaktuar ia dorëzoi zyrtarisht Ministrisë së Kulturës, draftin përfundimtar të Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit. Projekti u financua nga AADF me një kosto prej rreth 250,000 dollarë.

Ajo që lexuesi nuk mund të vlerësojë është se Bordi i AADF-së, përveç kryetarit, nuk ka pasur asnjë rol në asnjë nga këto hapa dhe as nuk ka parë ndonjë nga këto dokumente.

Më duhet të theksoj sërish se bordi kishte miratuar vetëm konceptin që iu dha në formë propozimi dhe buxhetin përkatës. Ndërkohë që bashkëdrejtuesit (CEO-të) në mbledhjet e bordit informuan bordin për progresin që po bëhej, por as draftet e ligjeve dhe as menaxhmenti i integruar nuk iu qarkulluan bordit, megjithë kërkesat e mia të

përsëritura për një kopje, ato ranë në veshin e shurdhër të kryetarit dhe CEO-ve. Përkundrazi, më thanë se miratimi i këtyre dokumentave nuk ishin përgjegjësia e bordit, me të cilin unë nuk u pajtova me mirësjellje. Më pas pyeta: “Të paktën t’i kemi ato që të mund të përfshihemi në një bisedë inteligjente”, **por pa dobi.** Prandaj, meqë nuk i kam lexuar kurrë, nuk mund t’i komentoj në lidhje me përputhshmërinë e tyre me normat kombëtare ose ndërkombëtare dhe udhëzimet përkatëse, apo për sa i përket efikasitetit të tyre. **Një çështje tjetër shqetësuese, e cila nuk u raportua dhe as u diskutua siç duhet midis anëtarëve të bordit, është niveli i mosmarrëveshjeve nga arkeologët dhe studiuesit më të lartë të vendit, historianët, ish-zyrtarët dhe nga publiku në përgjithësi.**

Nga ajo që është postuar në faqen e AADF-së dhe nga ato që na thanë në mbledhjet e bordit, ne kishim përshtypjen se gjithçka po shkonte mirë, **përveç disa ankesave të disa individëve që sipas tyre kishin qëllime të fshehta për të ngritur zërin. Por nuk ishte kështu.**

Në qershor të vitit 2020, Auron Tare, një nga themeluesit e Parkut Kombëtar të Butrintit dhe ish-drejtor i Trashëgimisë Botërore Nënujore në UNESCO, i dërgoi një e-mail sekretares së bordit tonë, në të cilin isha ‘cc’, **ku ai ngrinte shqetësime se nëse bordi po merrte informacion të saktë në lidhje me reagimet publike që kanë të bëjnë me planet tona të parashikuara për Butrintin.** Duke iu referuar një takimi publik në Tiranë në ambientet e AADF ku përfshiheshin disa personalitete të profilit të lartë të përfshirë në trashëgiminë kulturore, përfshirë Neritan Cekën, një arkeolog i njohur shqiptar me reputacion ndërkombëtar, ata me sa duket ngritën një sërë pyetjesh dhe shqetësimesh serioze mbi strategjitë dhe qasjet e AADF në lidhje me Planin e Menaxhimit të Integruar. **Ata besonin se firma e punësuar për të hartuar planin e menaxhimit nuk kishte ekspertizën dhe kualifikimet e nevojshme për të shkruar një plan të tillë për Butrintin, i cili është një vend mjaft i ndërlikuar dhe gjithashtu shumë i rëndësishëm për kombin.**

Më tej, ai e konsideroi seriozisht fyes faktin se plani i menaxhimit i parashikuar nuk kishte referencë për asnjë studiues shqiptar që punonte në Butrint që nga vitet 1930, por fillon me punën e një arkeologu britanik në vitin 1994. Megjithatë, çështja më shqetësuese për ta ishte se plani rekomandonte që Parku Kombëtar i Butrintit të menaxhohej nga një palë e tretë e pavarur: një sugjerim i cili ju duk shumë shqetësues gjithë grupit interesues të trashëgimisë kulturore shqiptare.

E-mail-i i tij drejtuar sekretares të bordit u pasua nga një tjetër e-mail me disa bashkëngjitje shkrimesh mediatike për çështjen e Butrintit të publikuara në mediat shqiptare. Është e panevojshme të thuhet se asnjëra nuk iu shpërnda bordit, përkundrazi, kryetari e udhëzoi sekretaren që t’ua përcjellë ato bashkëdrejtuesve në Tiranë. Duke qenë se isha cc në e-maillet e zotit Tare, kishte një insinuum se mund të kisha diçka me të, gjë që ishte krejtësisht absurde. Zotin Tare e kam takuar vetëm një herë në Tiranë për një çështje personale, shumë kohë përpara se të përfshiheshim në Butrint. Na u tha se ka pasur disa ankesa të tjera në bordin dhe

të paktën një në USAID, por si zakonisht ato nuk janë ndarë me bordin. Përsëri, unë shpreha shqetësimet e mia në lidhje me trajtimin tonë të korrespondencës drejtuar bordit, duke deklaruar se komunikimi i lartpërmendur duhet të qarkullohet tek të gjithë anëtarët dhe, bazuar në meritat e tyre, të diskutohet dhe të bihet dakord për përgjigjen, e jo t'i dërgohen në mënyrë rutinore bashkëdrejtuesve për trajtim. Pas mbledhjes, kryetari më pyeti privatisht nëse i njihja personat që i shkruanin, duke bërë sërish një sugjerim fyes se mund të kem qenë i përfshirë në një farë mënyre.

Për mendimin tim, thelbi i problemit që me të drejtë ka shkaktuar bujë është mungesa e transparencës me themelimin e respektuar të fondacionit privat për zbatimin dhe administrimin e Planit të Menaxhimit të Integruar dhe mënyrën se si supozohet të funksionojë.

As dokumentet e themelimit dhe as marrëveshja e funksionimit nuk janë venë bordit në dispozicion, – përveç ndoshta kryetarit – megjithatë, unë nuk jam në gjendje të komentoj për atë që është bërë, por mund të komentoj atë që duhet të ishte bërë. **Si fillim, organizata e re duhet të jetë në një formë partneriteti privat-publik midis qeverisë dhe AADF, duke ofruar menaxhim pa pronësi, përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e zonës së trashëgimisë së Butrintit duke përdorur praktikën më të mira në fushën e trashëgimisë kulturore.** Siç nënkupton edhe vetë emri, Plani i Menaxhimit të Integruar supozohet të integrojë të gjitha sistemet dhe proceset e tij në një kuadër të plotë, duke e lejuar atë të funksionojë si një njësi e vetme me objektiva të unifikuar; megjithatë, një sipërmarrje e tillë është mjaft komplekse dhe shkon përtej zbatimit të përcaktuar të një plani të përpiluar nga konsulentë **me pak ose aspak angazhime me profesionistë vendas të trashëgimisë dhe me pak dëshirë për të ndërtuar kapacitete për të mbështetur procesin.** Prandaj, ishte e domosdoshme të mblidheshin që në fillim të gjithë ekspertët dhe palët e interesuara relevante vendore për të punuar në mënyrë proaktive në formulimin e planit dhe më pas të mblidheshin si një. Përgjegjësitë e secilit aktor duhet të përcaktohen qartë dhe të bien dakord me shkrim. Gjithashtu, administruesit e besuar të organizatës duhet të përbëhen nga përfaqësues nga aktorët kryesorë dhe ekspertë nga fusha të zbatueshme, si arkeologjia, restaurimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi urban, etj. Me nënkuptim që jo vetëm pronësia apo edhe përgjegjësia e Parkut të Butrintit t'i ngelet shtetit, dhe se organizata e krijuar për të zbatuar planin e Menaxhimit të Integruar, nuk është tjetër veçse një “agjent” i Ministrisë së Kulturës dhe që funksionon në pajtim të një marrëveshjeje përmes tyre. **Isha shumë i pakënaqur kur mësova për administruesit e fondacionit të sapokrijuar, pasi kuptova se projekti ynë me synim të mirë u rrëmbye ose u mashtrua pa dashje. Është e qartë se bordit të ngritur i mungon ekspertiza e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive Planin e Menaxhimit të Integruar dhe për të mbikëqyrur punët e Butrintit.**

Organizata e krijuar për të zbatuar Planin e Menaxhimit të Integruar dhe për të drejtuar operacionet e përditshme të biznesit duhet të ketë një objektiv më të madh: që është të mbledhë të gjithë historianët dhe arkeologët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të rishkruar historinë e Butrintit dhe për ta paraqitur atë në botë si Buthrotum i antikitetit. Qytet ilir, dhe jo thjesht si një vend i kolonisë greke dhe një qytet romak. Natyrisht, një qytet i vjetër, gjatë historisë është pushtuar ose sunduar nga një sërë perandorish, duke përfshirë edhe atë greke dhe romake, por kjo nuk e ndryshon origjinën dhe vërtetësinë e tij. Është një fakt historik i njohur se Buthrotumi ose Butrinti i sotëm, qytet i fisit Epirot të Kaonëve, ka qenë i banuar që në kohërat parahistorike. Është gjithashtu një fakt i vërtetuar historik se Epirotët (Kaonët, Molosët dhe Dhesprotët) ishin fise ilire, gjuha e tyre ishte një dialekt shqiptar dhe mbreti i tyre i famshëm Pirro (në shqip Piros) është një nga mbretërit ilirë më të njohur. Kjo pjesë e fundit kontestohet nga Greqia moderne për të justifikuar pushtimin e Çamërisë dhe pretendime të tjera. Identiteti historik nuk është e vetmja gjë që u vodh nga Butrinti. Dy statuja të lashta prej mermeri të Artemidës dhe Apollonit, së bashku me shumë gjetje nga gërmimet e mëparshme, u vodhën. Për fat, dy statujat u gjetën në Greqi dhe u kthyen në Shqipëri. Hapja e Shqipërisë tërhoqi shumë institucione të huaja të interesuara për të gërmuar në Butrint, por jam skeptik nëse ata kishin një synim të sinqertë për të zbuluar të vërtetën, apo për të vënë një vulë greko-romake në këtë vend të madh arkeologjik dhe kulturor shqiptar me rëndësi ndërkombëtare. Qeveria shqiptare duhet të jetë e kujdesshme me kë do të hyjë në partneritet për të menaxhuar Parkun Kombëtar të Butrintit dhe si bëhet ajo. Mendoj se bordi i parashikuar siç është propozuar nuk e ka ekspertizën apo edhe vullnetin për të zbardhur të vërtetën për Butrintin dhe për ta shfaqur atë në Botë si një trashëgimi historike dhe kulturore shqiptare. Është e trishtueshme, sepse me zbatimin e një Plani të Menaxhimit të Integruar të mirë-projektuar dhe të zbatuar mirë, shpresoja se do të bëhej një Roseta Stone për vendet e tjera historike dhe kulturore në Shqipëri e jo ajo ç'ka doli, një Kalë Troje.

Si përfundim, i qëndroj deklaratës sime të mëparshme se bordit nuk i janë paraqitur të gjitha faktet dhe dokumentet në lidhje me këtë projekt; përndryshe, ne mund të kishim vepruar ndryshe. Një keqkuptim i projektit, mungesa e transparencës dhe përjashtimi i ekspertizës vendore nga drejtuesit e AADF-së luajtën një rol kyç në zhgënjimin e publikut me AADF-në për përfshirjen e saj në zonat e trashëgimisë së Butrintit. Ndonëse ka mjaft faj për të ndarë, individët, që duhet të mbajnë përgjegjësi për këtë fatkeqësi janë dy bashkëdrejtorët dhe kryetari i bordit të AADF-së, sepse ata keqmenaxhuan atë që supozohej të bëhej një projekt i mrekullueshëm”.

Linqe të reagimeve publike apo diskurseve lidhur me Parkun Kombëtar të Butrintit dhe dhënien në administrim të tij

<http://www.gazetatema.net/2020/06/16/larg-duart-nga-butrinti/>

<https://www.zeriamerikes.com/a/6517829.html>

<http://www.panorama.com.al/skandali-butrinti-me-koncesion-me-marveshje-sekrete-cfare-fshihet-pas-dokumentit-te-depozituar-ne-kuvend/>

<https://telegraf.al/aktualitet/ish-kongresmeni-amerikan-joseph-j-dio-guardi-leter-unesco-s-shpetoni-butrintin/>

<https://www.syri.net/politike/505300/nga-problemet-e-ligjit-tek-dergimi-ne-kushtetuese-merxhani-flet-ne-a-show-per-koncesionin-e-butrintit/>

<https://www.syri.net/politike/506917/koncensioni-i-butrintit-ish-drejtori-i-unesko-pergjegjesia-i-mbetet-gjithnje-shtetit-shqiptar-ja-cfare-po-kerkojme/>

<https://www.syri.net/politike/506922/koncensioni-i-butrintit-bace-shpirti-i-kombit-nuk-lejohen-fondacionet-vendase-e-jo-me-te-huaja/>

<https://www.syri.net/politike/507800/thirrje-vetedijes-kombetare-aleanca-per-mbrojtjen-e-butrintit-organizon-tryeze-diskutimi-me-ekspertet-e-fushes/>

<https://www.balkanweb.com/debati-per-parkun-kombetar-te-butrintit-granoff-per-voa-nuk-do-te-ndertohet-asnje-hotel-apo-objekt-tregtar/>

<https://www.syri.net/politike/507803/asnje-ndertim-ne-zonen-e-mbrojtur-te-butrintit-granof-per-voa-mbrojtja-e-territorit-pergjegjesi-e-qeverise/>

<https://lapsi.al/2022/05/21/manastiri-resort-ne-zonen-e-mbrojtur-te-butrintit-michael-granoff-pyetje-legjitime-por-eshte-pergjegjesi-e-qeverise/>

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid05uDxDRcMSp3tf4wHiVJVn89o2oeXcLWFjA4aukZXc1qAvFfVGAUP9TxfRVdsmDGwl&id=100044228000110

<https://www.syri.net/politike/508005/auron-tare-zberthen-deklaratat-e-michael-granoff-cfare-fshihet-pas-projektit-per-parkun-e-butrintit/>

<http://www.panorama.com.al/dhenia-e-butrintit-me-koncension-berisha-mes-protestuesve-perpara-kuvendit-doktor-duam-popullin-ne-kembe-kreu-i-pd-patjeter-e-garantoj-ramen-se/>

<https://www.syri.net/politike/508536/koncension-i-butrintit-dr-jasini-mungese-transparence-thyerje-e-konventes-se-parisit-trajtim-preferencial/>

<https://www.syri.net/politike/509585/koncension-ne-kushtetuese-kalaja-nga-butrinti-e-paskamarre-greku-donim-te-hynim-ne-park-por-nuk-na-lane/>

<https://www.politiko.al/e-tjera/cafo-boga-saga-e-butrintit-i461562>

https://telegraf.al/aktualitet/cafo-boga-vazhdon-saga-lidhur-me-butrintin/?fbclid=IwAR2YoKbvX7YVwBDjxM7JkgxOkvlpMN6nyc_8n3XPA_1oI6SUYKhEgCi-Mg8

<https://telegrafi.com/cafo-boga-shqiptari-qe-kaperceu-te-gjitha-barrierat-dhe-realizoi-nje-histori-sukses-ne-amerike/>